



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:088790

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06372025

**C.nr.1493/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të cilën e përfaqëson B.L. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 1,132.32 euro, jashtë seance, me datë 30.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses B.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që *“të detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar t’i paguaj (kompensoi) 2 (dy) paga mujore neto, në shumën prej 1,131.32 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”*.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja B.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore&Financiare “Klinaku ....” me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, me datën 04.05.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 1,131.32 euro.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se paditësja B.K. është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, për më tepër se 20 vite në SHSKUK, në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratën Sektoriale e nënshkruar me 12.06.2018, mes Qeverisë

së Kosovës-Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, nuk e ka bërë kompensimin e një page neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së një page neto për shpërblimin jubilar, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditëses. Sipas të autorizuarit të paditëses paga mujore neto e të njëjtës është 296.00 euro, e cila vërtetohet nga lista e pagës, ku sipas përvojës së punës i takon shuma e përgjithshme prej 592.00 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të përfaqësuesit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Gjithashtu ka theksuar se paditësja marrëdhënien e punës me kohë të caktuar (kohëzgjatje prej 6 muajsh) tek jo e paditura e ka filluar me datë 01.04.2022, deri me datë 30.09.2024, e njëjta nuk ka qenë punëto e Spitalit të Prizrenit, por ka pasur kontratë pune me Operatorin Ekonomik të kontraktuar nga Spitali i Prizrenit, andaj edhe kërkesën e saj është dashur ta orienton tek Operatori Ekonomik në këtë rast N.SH.H “ALBAS”, pasi me të ka pasur kontratë pune me kohë të caktuar. Kërkesa e paditëses është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale e cila ka përfunduar me datë 12.06.2021. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditëses është e pathemeltë.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka lidhur kontratën e punës për kohë të caktuar dhe orar jo të plotë me N.SH.H “ALBAS” me seli në Prizren, nga data 01.04.2022, deri me datë 30.09.2022, e caktuar në vendin e punës ndihmëse-servuese e ushqimit nëpër reparte të Spitalit Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, fakt ky i vërtetuar nga provat (kontrata e punës) të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e të dorëzuara nga pala paditëse.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë kontratën e marrëdhënies së punës me numër të protokollit 7/22, të datës 28.03.2022, e lidhur mes këtu paditëses B.K. dhe operatorit N.SH.H “ALBAS” me seli në Prizren, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Kjo për faktin se kërkesa për kompensimin e pagës jubilarë është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që me nenin 17 par.3 nen par.3.2 të Kontratës së Kolektive Sektoriale, e datës 11.06.2018, me numër të njësisë 01, numër të prot.05-3815, të datës 12.06.2018, e cila parasheh që “3. Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.2 Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij”, si dhe duke u bazuar në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, në pikë V, përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data

11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që “punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit”. Padiësja B.K. nga Prizreni, marrëdhënien e punës nuk e ka krijuar pranë të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Prim.Dr. Daut Mustafa” në Prizren, përkatësisht e njëjta kontratën e punës e ka lidhur me operatorin N.SH.H “ALBAS” me seli në Prizren, me datë 28.03.2022 dhe e njëjta nuk i ka 20 vite përvojë pune pranë këtu të paditurës. Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se padiësja nuk ka plotësuar kushtin e kërkuar në nën par, 3.2 të paragrafit 3 të nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale, datës 11.06.2018, me numër të njësisë 01, numër të prot.05-3815, dhe kushtin e paraparë në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, në pikën V dhe në pikën IX, e që është përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit, për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiësë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.1493/2022, datë 30.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.